



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

DT 31/12/2024.
N 484 PRO

V E N D I M

Nr. 856, datë 26.12.2024

P Ë R

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.893, DATË 27.12.2022,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT
"EKIPET SPORTIVE NË SHKOLLA", NË KUADËR TË LËVIZJES
OLIMPIKE SHQIPTARE TË KOMITETIT OLIMPIK KOMBËTAR
SHQIPTAR (KOKSH)", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, pika 1, dhe 15, të ligjit nr.79/2017, "Për sportin", të ndryshuar, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të shkronjës "a", të pikës 13, të nenit 11, të ligjit nr.97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.893, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për financimin e projektit "Ekipet sportive në shkolla", në kuadër të lëvizjes olimpike shqiptare të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH)", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Titulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Për financimin e projektit "Ekipet sportive në shkolla", në kuadër të lëvizjes olimpike shqiptare, dhe për aktivitete në kuadër të ndërkombëtarizimit të sporteve të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH)".

b) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Financimin në masën 750 000 000 (shtatëqind e pesëdhjetë milionë) lekë të projektit “Ekipet sportive në shkolla”, në kuadër të lëvizjes olimpike shqiptare të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), dhe financimin në masën 200 000 000 (dyqind milionë) lekë të projektit “Ekipet sportive në shkolla”, në kuadër të lëvizjes olimpike shqiptare të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) dhe për aktivitete në kuadër të ndërkombëtarizimit të sporteve, të ndarë, si më poshtë vijon:

- a) 250 000 000 (dyqind e pesëdhjetë milionë) lekë nga fondet buxhetore të vitit 2022;
- b) 350 000 000 (treqind e pesëdhjetë milionë) lekë nga fondet buxhetore të vitit 2023;
- c) 150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) lekë nga fondet buxhetore të vitit 2024;
- ç) 200 000 000 (dyqind milionë) lekë nga fondet buxhetore të vitit 2024 për projektin “Ekipet sportive në shkolla” dhe për aktivitete në kuadër të ndërkombëtarizimit të sporteve.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

**MINISTRI I ARSIMIT
DHE SPORTIT**

OGERTA MANASTIRLIU

NR.PROT. 7099/1
DATE 27.12.2024

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT
KOMITETIT OLIMPIK KOMBËTAR SHQIPTAR
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI

